



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për buxhet dhe financa
Legjislacioni i III
6 mars 2008
P r i s h t i n ë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Komisionit për buxhet e financa

Mbledhja u mbajt më 6.03.2008 në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, sala C-203, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e Shërbimit të sekretarisë së Kuvendit, përfaqësuesit e monitorimit të OSBE-së, NDI dhe përfaqësuesit e ftuar të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik: Ramadan Gashi dhe Nexhat Shabani, anëtarë të bordit.

Në mbledhje nuk morën pjesë: Hajdin Abazi dhe Behxhet Pacolli, anëtar të Komisionit.

Kryetari i komisionit e hapi mbledhjen dhe propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të datës 13 dhe 14 shkurt 2008,**
- 3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik në Kosovë për vitin 2007**
Të ftuar:
 - **Përfaqësuesit e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për pengimin e shpëlarjes së parave,**
- 5. Të ndryshme**

Pas konstatimit që rendi i ditës të plotësohet me pikën 5.1. propozim me rekomandim lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe grupeve parlamentare për vitin 2008, kryetari filloi me shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të datës 13 dhe 14 shkurt 2008-03-13

Kryetari konstatoi se i njëjti miratohet pa vërejtje dhe filloi me shqyrtim pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit rregullativ për prokurim publik në Kosovë për vitin 2007

Kryetari i komisionit foli për obligimin, qëllimin dhe domosdoshmërinë e shqyrtimit të raportit të këtij Komisioni lidhur me aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2007 dhe theksoi dispozitën 5 (a) dhe (b) të Kornizës kushtetuese, rregullës 51.2. dhe 3. të Rregullores për punën e Kuvendit, nenit 82.2 (i) të Ligjit për prokurim publik nr. 2007/20, përkatësisht obligimet ligjore të raportimit të KRPP Kuvendit dhe Qeverisë.

Ai gjithashtu theksoi se raporti paraqet punën njëvjeçare të KRPP-së lidhur me aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë karshi burimeve financiare, vlerave të marrëveshjeve për prokurim, llojeve, aktiviteteve dhe procedurave të prokurimit dhe ka ftuar përfaqësuesit e KRPP-së që para Komisionit ta paraqesin raportin me qëllim të fillimit të shqyrtimit, vlerësimit dhe çështjeve të tjera në interes për Komisionin.

Ramadan Gashi anëtar dhe zëvendës i kryetarit të KRPP-së, në pjesën hyrëse të prezantimit të vetë ka theksuar strukturën e raportit dhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, veçanërisht duke theksuar të metat, përparësitë dhe dobietë e këtij raporti, sikur për Kuvendin ashtu edhe për Qeverinë dhe institucionet financiare ndërkombëtare monetare në Kosovë. Në vazhdim ai foli për disa elemente të rëndësishme të raportit që meritojnë kujdes të veçantë. Para së gjithash, përpjekjet e KRPP-së që raporti të hartohet në pajtim me ligjin e ndryshuar për prokurim publik, që ka hyrë në fuqi më 6.06.2007, njëkohësisht duke i respektuar kërkesat e rregullave të prokurimit të BE, sikur edhe rrethanat që ekzistojnë në fushën e prokurimit publik në periudhën 2004-2006.

Veçanërisht ka theksuar se ligji i ndryshuar parashikon formimin e tri organeve qendrore, prej të cilëve paneli për ankesa, anëtarët e të cilit Kuvendi ishte i obliguar që ti emërojë, por kjo nuk ndodhi, kështu që afati është shtyrë deri më 31 mars të këtij viti. Pastaj, ligji i ndryshuar kishte për qëllim thjeshtësimin e procedurave të prokurimit dhe shkurtimin e afateve, me ç'rast është realizuar një takim i zyrtarëve të Agjencisë për prokurim publik me Ministrinë e financave ku mori pjesë një numër i përfaqësuesve të Bankës botërore. Propozimi është dhënë me sugjerim që afati ligjor për dorëzimin e tenderit është i shkurtë, kështu që afatet për tubimin e të dhënave duhet të dyfishohen, veçanërisht kur bëhet fjalë për marrëveshje publike me vlera të mëdha me qëllim të zbatimit më të lehtë dhe më efikas të ligjit për prokurim publik (LPP) dhe rritjen e fondeve publike. Gjithashtu, ka theksuar se Komisioni për prokurim publik në vitin e kaluar ka realizuar bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtar për prokurim dhe ka realizuar disa vizita jashtë Kosovës, si dhe ka theksuar se AER edhe në të ardhmen do ta përkrahin reformën e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

Pas ekspozesë hyrëse të anëtarit të KRPP-së, kryetari i komisionit ka ftuar anëtarët që të marrin pjesë në shqyrtimin e raportit dhe ti japin mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Myrvete Pantina ka paraqitur këto vërejtje dhe çështje:

- Raporti nuk ofron pasqyrën e të dhënave statistikore për prokurim publik, përkatësisht nuk përmban të dhënat dhe gjendjen e autoriteteve kontraktuese nga viti 2007, në raport me vitin e kaluar, dhe kjo paraqet një nga mungesat në raport;
- Një nga parimet e LPP është parimi i barazisë dhe transparencës që nënkupton qasje direkte për çdo kopje të dokumentacionit të çfarëdo aktiviteti të prokurimit publik dhe qasje të arsyeshme për çdo individ që kërkon qasje në të dhëna, kështu që parashtrohet pyetja e saktësisë së të dhënave dhe shkallës së transparencës.
- Duke u bazuar në rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, kërkohet procedura për hartimin e rregullativës që përfshinë fushën e prokurimit tek kompanitë publike në pajtim me rregullat e prokurimit të BE-së, kështu që duhet të sqarohet pse ato nuk janë të barabarta me kompanitë private.

Haki Shatri ka dhënë disa sugjerime dhe vërejtje në raportin e ofruar, por ka veçuar:

- Në parim e përkrahë raportin si të pranueshëm dhe pozitiv, por jo perfekt, duke marrë parasysh për rëndësinë e tij për sistemin e përgjithshëm të prokurimit publik në Kosovë, si dhe se e ka vëzhguar punën e Komisionit në kohën kur ai ishte ministër;
- Pastaj, ka theksuar se Qeveria nuk guxon të përzihet në procesin e prokurimit publik ngase kjo nuk lejohet me ligj, por vetëm Kuvendi që emëron anëtarët e Komisionit rregullativ, kështu që Qeveria duhet ti respektoj kërkesat për anëtarësim, të specifikuara në nenet 86.3 – 86.4 LPP dhe KRPP, gjithashtu ka kompetenca dhe përgjegjësi që ta vëzhgojë dhe përcjell zbatimin e këtij ligji dhe rregullave që nxjerr KRPP në bazë të autorizimeve që i ofrohen me ligj.
- Çështje që nuk është rregulluar është shqyrtimi i ankesave të operatorëve ekonomik në panelin për ankesa gjithësi mbetet si kërkesë juridike obliguese.

Safete Hadergjonaj ka dhënë disa vërejtje kyçe, por ka veçuar:

- Mosekzistimin e dallimit ndërmjet raportit të sivjet dhe të atyre të viteve paraprake. Më shumë i janë dhënë të dhënat statistikore se sa janë paraqitur disa rezultate apo aktivitete të Komisionit, në qoftë se dihet se është përgjegjëse për kryerjen e funksionit që iu është ndarë sipas ligjit për hartimin dhe ekzekutimin e rregullave të prokurimit dhe sistemit të prokurimit publik, zhvillimin e përgjithshëm, punën dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, që në raport nuk mund të vërehet.
- Mungesa e ekspertëve në bord me një përvojë të konsiderueshme në prokurim;
- Është në kundërshtim me raportin e auditorit gjeneral i cili tregon gjendjen e keqe dhe të mjerueshme në lëmin e prokurimit publike.
- Është i pakuptimtë dhe qesharak pjesa e raportit e cila bën fjalë për shqyrtimin e ankesave kështu që nuk dihet çka ka bërë komisioni, por vetëm vërehet një numër i shqyrtimeve dhe mos shqyrtimeve të ankesave pa arsye të vlerësimit të kontratave të cilat janë objekt i ankesave.

- Në pjesën për rekomandime janë evidente shumë shkelje të ligjeve dhe nuk dihen se cilës natyrë i përkasin, gjithashtu nuk parashihen as masat ndëshkuese të cilat merren në rastet e shkeljes së ligjit, këtu vetëm sugjerohet trajnimi i zyrtarëve për prokurime dhe zvogëlimi i afatit të trajnimeve nga 10 në 5 ditë. Arsyeshmëria e shkeljes së ligjit është paraqitur si njohuri e mangët e ligjeve, dhe ndërsa si masë është propozuar trajnimi i zyrtarëve të prokurimit, që do të thotë se është e papranueshme kur merret parasysh gjendja jo e mirë në lamin e prokurimit publik;

Armend Zemaj është i interesuar dhe ka ndier nevojën për t'u njoftuar me pjesën e raportit që është i thirrur departamenti i trajnimeve dhe kërkon dy skjarime:

- Sa përcillet përparimi i trajnimeve të zyrtarëve për prokurime publike dhe a ka rol aktiv RKJN në këtë proces apo vetëm e ka rolin e monitoruesit;
- Sa është RKJN-a marr me procesin e inspektimit të kontratave me vlera të larta;

Xhevdet Neziraj ka theksuar një fakt shumë të rëndësishëm në lidhje me sistemin e prokurimeve publike dhe ligjin që është në fuqi nga lëmia e prokurimit publik:

- LPP i cili është në fuqi përmban shumë mangësi dhe ka pak iniciativa që ky të ndërrohet me qëllim që të përmirësohet gjendja në sistemin e prokurimit publik në Kosovë. Agjencionet të cilat e implementojnë ligjin e prokurimit publik dhe të cilat i vërejnë këto mangësi dhe kërkojnë ndrimin e ligjit është mirë që të paraqesin propozimet e tyre për amendamentim të të njejtë e jo vetëm të konstatojnë shkeljet dhe të vazhdojnë në situatë të njejtë të vështirësive në prokurimin publik.

Kryetari i Komisionit, Gani Koci bëri fjalë për disa çështje që posaçërisht janë akcentuar në kapitujt 5 (a) dhe (b) të Kornizës Kushtetuese, regulla 51.2 dhe 3 të rregullores së Kuvendit, neni 82.2 (i) të Ligjit mbi prokurimin publik nr. 2007/20, si dhe obligimin e komisionit për buxhet dhe financa ta shqyrtojë në mënyrë që Kuvendi të shqyrtojë raportin e RKJN-së. Gjithashtu paraqiti disa vërejtje dhe kritika që i ka vërejtur vet dhe kërkoj që ato më të rëndësishmet t'i akcentojë:

- Raporti nuk përmban ndryshime në bazë të raportit të vitit 2006 dhe është në kundërshtim në raportin e revizionit gjeneral i cili paraqet gjendjen e vështirë në lamin e prokurimit publik;
- Vërejtja kryesore në raport bënë fjalë për pjesën që quhet departamenti për trajnime, mbikëqyrje dhe ankesa, nga se raporti nuk përshkruan natyrën e shkeljeve të ligjit të përgjegjësive dhe nuk propozon masa ndëshkuese për shkelësit e ligjit. Arsyetimi për shkeljen e ligjeve është paraqitur në mënyrë të pamjaftueshme duke u thirrur në ligj ndërsa si masë për përmirësim në këto raste propozohet trajnimi i zyrtarëve të prokurimit gjë që është e palejueshme, ngase problemet dhe kapaciteti i njerëzve që janë të obliguar të implementojnë dhe të mbikëqyrin ligjin.
Kjo masë nuk arsyeton kështu gjendjen në prokurimin publik, meqenëse ligji i obligon zyrtarët të marrin pjesë në trajnime adekuate për mbikëqyrje dhe implementim të ligjit në prokurimin publik. Konstatimet e tilla nuk kanë bazë;
- Raporti paraqet shënimet ma shumë në formën statistike të pa përshkruara dhe arsyetuara kështu që një formë e tillë e raportimit është e pamjaftueshme dhe nuk përmbushë standardet e raportit, dhe si i tillë nuk mund të pranohet me pjesë të tij.

- KRRPP në raportin e tij ka identifikuar dhe shqyrtuar 246 ankesa nga ana e autoritetit kontraktues, mirëpo nuk ka paraqit vlerën e kontratave të tilla të cilat janë edhe objekt i ankesës, njëherit nuk ka ofruar sqarime që është një mossakses ;
- Për kryerjen e veprimtarisë së prokurimit të paraparë me ligjin gjatë vitit 2007 KRRPP ka hargjuar 40% të buxhetit, është kjo një e dhanë befasuese dhe duhet të arsyetohet me fakte;
- Është e papranueshme praktika që iniciativat për ndryshimin e ligjeve të presin nga AER-i nga se po kopjohen ligjet të cilat nuk mund të implementohen në Kosovë;
- Sa respektohen nenet 7.1 dhe 7.2 të Ligjit të LPP në pjesën e planifikuar të prokurimit publik;

Pas paraqitjes së këtyre komenteve dhe vërejtjeve të deputetëve përfaqësuesit e KRRPP-së pjesërisht ju përgjigjen shumë vërejtjeve dhe pyetjeve që kanë të bëjnë me raportin mbi aktivitetin e prokurimit publik për vitin 2007, ndërsa Komisioni pas shqyrtimit, me shumicë votash bie këtë :

Përfundim

1. Aprovohët në parim Raporti i Komisionit rregullativ (KRRPP) mbi aktivitetin e prokurimit publik për viti 2007, dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që të njëjtin ta rradhitë në rend dite për shqyrtim në seancën Plenare.
2. Rekomandohët Kuvendi dhe Qeverija që të veprojnë në mënyrë konkrete përformimin e organit për shqyrtimin prokurimit publik, në bazë të nenit 96.4 tëLigjit mbi prokurimin publik.

Kryetari hapi shqyrtimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi Projekt ligjit për parandalimin e pastrimit të parasë.

Fjalën e rastit për këtë pikë e mbajti kryetari i Komisionit Gani Koci cili të pranishmit i njoftoj me punën e tërësishme rreth shqyrtimit tëkëtij Projekligji në mandatin e kaluar. Raporti për dëgjim të dytë për Kuvend është përgatitë para zgjedhjeve dhe shpalljes së Pavarisë së Kosovës dhe pranimit ndërkomtar, por edhe tani ka vend për amendamentim evëntual. Mirpo, parashtrohet pytja e rolit dhe kompetencave të UNMIK-ut dhe PSSP, gjithashtu mbetet e pa qartë çështja e ligjeve të cilat deri me tani kanë qenë të rezervuara me kompetencë të PSSP. Janë paraqitë veshtëresi për procedim të këtij P/ligji për shkak të kompetencave të rezervuara të PSSP. Për këtë është e nevojshme të kërkohet sqarim prej institucioneve të Kosovës për hartimin e legjisllacionit nga se nuk janë të qarta kompetencat e institucioneve të Republikës së Kosovës për hartimin dhe procedimin e ligjeve që ishin në kompetencë të PSSP.

Haki Shatri, mbështeti mendimin e kryetarit dhe theksoj nevojën e rregullimit të kësaj çështje në rrethana të reja,që do të thotë se përgatitjet për raport me amendamente të Komisioni për buxhet nga mandati i kaluar, mund të plotësohet dhe adaptohet me rrethana të reja në mbështetje të ekspertit në mënyrë që të përmblihet i gjithë procesi i punës të këtij P/ligji. Pas konsultimeve të shkurta rreth çështjes së kompetencave të institucioneve të Republikës së Kosovës për ligjet që ishin të rezervuara me Kompetencë të PSSP, Komisioni bie këtë :

PËRFUNDIM

Në emër të Komisionit për buxhet, t'i drejtohet me shkresë kryetarit të Kuvendit Jakup Krasniqit për nismën e procedurës për shpjegimin e kompetencave për ato ligje që ishin të rezervuara nga PSSP.

5.1 Të ndryshme

Propozimi me rekomandime lidhur ndarjen e mjeteve financiare të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe grupeve parlamentare për vitin 2008

Në bazë të rregullës 6.7 dhe 51.2 të rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për buxhet dhe financa ka shqyrtuar çështjen e ndarjes së mjeteve financiare për financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe financimin e grupeve parlamentare dhe Kryesisë së Kuvendit paraqet këtë

Propozim

I.

Në kuadër të buxhetit të miratuar për Kuvendin e Kosovës për vitin 2008, mjetet financiare nga kategoria e ndihmave dhe transferim janë nda mjete financiare për partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës.

Këto mjete të ndahen sipas kriterëve për vendet e fituara në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

II.

Për financimin grupeve Parlamentare të ndahen 5% të mjeteve të ndara sipas pikës I. Këto mjete (5%) ndahen vetëm për grupet Parlamentare që përbejnë partitë politike, nga buxheti i paraparë për partitë që janë të përfaqësuara në grupet parlamentare. Nëse në përbërje të një grupi parlamentar janë dy ose më shumë parti, mjetet ndahen në propocion me përfaqësimin e tyre në grupet parlamentare.

Mjetet u ndahen grupeve parlamentare nga ana Kuvendit të Kosovës dhe për këtë shkak grupet parlamentare duhet me i pas xhirollogaritë e tyre .

Bashkangjitur: Forma tabelare e ndarjes së mjeteve financiare nga pika I dhe II.

Nr.	Titulli i partisë	Nr. i deputetëve	Ndarja preporcionale sipas numrit të deputetëve	Grupet parlamentare 5%	Pjesa tjetër për partitë politike
1	PDK	37	586,383.09	29,319.15	557,063.94
2	LDK	25	396,204.79	19,810.24	376,394.55
3	AKR	13	206,026.49	10,301.32	195,725.17
4	LDD	11	174,330.11	8,716.51	165,613.60
5	AAK	10	158,481.92	7,924.10	150,557.82

6	SLS	3	47,544.58	2,377.23	45,167.35
7	KDTP	3	47,544.58	2,377.23	45,167.35
8	VAKAT	3	47,544.58	2,377.23	45,167.35
9	PDAK	3	47,544.58	-	47,544.58
10	SDSKIM	3	47,544.58	792.41	46,752.17
11	SDA	2	31,696.38	1,584.82	30,111.56
12	ND	1	15,848.19	792.41	15,055.78
13	GIG	1	15,848.19	792.41	15,055.78
14	SKMS	1	15,848.19	792.41	15,055.78
15	SNS	1	15,848.19	-	15,848.19
16	SNSDKIM	1	15,848.19	-	15,848.19
17	IRDK	1	15,848.19	792.41	15,055.78
18	PREBK	1	15,848.19	792.41	15,055.78
Okupno		120	1,901,783.00	89,542.28	1,812,240.72

Nr..	Emri i partisë që formojnë grupet parlamentare	Nr. deputetëve	Shuma për grupet parlamentare	Emri i grupeve parlamentare
1	PDK	37	29,319.15	PDK
2	LDK	25		19,810.24
3	AKR	13	10,301.32	AKR
4	LDD	11	8,716.51	LDD
5	AAK	10	10,301.32	AAK
6	SDA	2		
7	IRDK	1		
8	SLS	3	5,546.87	SLS
9	SDSKIM	1		

10	ND	1		
11	GIG	1		
12	SKMS	1		
13	KDTP	3		
14	VAKAT	3		
15	PREBK	1	5,546.87	7+
16	PDAK	3		Bez grupe
17	SDSKIM	2		Bez grupe
18	SNS	1		Bez grupe
19	SNSDKIM	1		Bez grupe
Gjithsejt			89,542.28	

Mbledhja përfundoi në 12:30

Njësia për komisionet parlamentare

**Kryetari i Komisionit
Gani Koci**